



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 3, 4 dhe 6 shtator 2019
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për një ndryshim në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", të ndryshuar""

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Elena Xhina, Ediola Braha, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

Mungojnë:

Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme!

Kuorumi është formuar për të vazhduar me dy çështjet, që kemi në rend të ditës.

Miratimi i procesverbaleve të datave 3, 4 dhe 6 shtator 2019.

Procesverbalet ju kanë ardhur me postë elektronike, sipas Rregullores. A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Kush është dakord me procesverbalet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohe.

Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës “Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar””.

Në shqyrtimin e këtij projektligji komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore do të jetë zonja Vasilika Hysi. Nga Ministria e Drejtësisë kemi ftuar në komision zëvendësministren e Drejtësisë, zonjën Fjoralba Caka.

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Gjithashtu kemi të pranishëm edhe zotin Besmir Beja, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Zonja Caka, ju lutem një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët e komisionit! Cilat janë arsyet që e kërkon këtë ndryshim në ligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”?

Më pas do t’ia kaloj fjalën koleges Hysi dhe do të vijojmë me pyetje nga kolegët deputetë. Përpara se t’jua kaloj fjalën, dua të bëj me dije se komisionit tonë i është bashkuar edhe një koleg tjetër nga Lëvizja Demokratike për Ndryshim, zotin Nikolin Staka.

Zoti Staka, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Zoti Staka do të jetë anëtar me të drejta të plota në komision, si përfaqësues i opozitës.

Me krahë të lehta!

Zonja Caka, fjala është për ju.

Fjoralba Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Propozimi që paraqesim sot konsiston në ndryshimin e vetëm dy dispozitave për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit. Konkretisht, ndërhyrja e parë që kërkohet është që të bëhet një ndryshim në nenin 10, paragrafi i dytë, lidhur me kriteret që duhet të plotësojë kandidati për kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimit. Propozimi i Ministrisë së Drejtësisë është që kriteri kufizues, që është në ligjin aktual, sipas të cilit kryetari duhet të ketë një diplomë në juridik, të zgjerohet, duke përfshirë edhe mundësinë e kandidimit të atyre personave, që kanë kryer studimet në shkencat humane, juridike dhe sociale.

Arsyeja e kësaj ndërhyrjeje është t'u japim mundësi personave, që kanë një fushë veprimtarie në birësime, në procedurat për birësime, psikologëve, punonjësve socialë, të cilët kanë qenë qoftë në gjykata, qoftë në procedurat e zgjidhjes së martesës dhe që e njohin mirë anën psikologjike, marrëdhëniet ndërpersonale prind-fëmijë, që t'i japin një kontribut dhe një vlerë të shtuar institucionit në raportet e birësimeve, i cili kërkohet jo vetëm nga kuadri ynë ligjor i brendshëm, por edhe në marrëveshje ndërkombëtare.

Kjo është arsyeja thelbësore pse kemi paraqitur këtë ndryshim në projektligj.

Dispozita e dytë ka të bëjë me hyrjen në fuqi. Nëse doni ta shtjelloj më tej, unë mund të përmend edhe arsye të tjera pse lindi nevoja për të bërë këtë ndryshim ligjor. Shpeshherë aplikimet që kemi pasur te Komiteti i Birësimit nuk kanë qenë aq të mira sa t'i plotësojnë të gjitha standardet e kërkuara nga ligji, kështu që nëpërmjet këtij ndryshimi ne kërkojmë të tërheqim një marzh më të gjerë ekspertësh për të garantuar që kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimit të plotësojë në mënyrë rigoroze kriteret për ta drejtuar këtë institucion.

Për këtë ndërhyrje ne kemi analizuar jo vetëm gjendjen aktuale në Shqipëri, por kemi parë edhe modele të vendeve të tjera lidhur me kryetarët e komiteteve të birësimit ose të atyre që janë këshillave të birësimi. Ajo që është vlerësuar nga Drejtoria e Kodifikimit është që shpeshherë ata nuk kanë vetëm profilin juridik, por kanë edhe profil ekonomik, të biznesit apo menaxheriale, madje shpeshherë janë punonjës të fushave sociale.

Duke u nisur edhe nga praktikat e vendeve të tjera ne menduam që kufizimi i vendosur në ligjin e mëparshëm nuk është i përligjur, pra nuk i shërben një qëllimi të përligjur për të bërë këtë ndryshim, që në vlerësimin tonë nuk është as proporcional. Gjithashtu, duke pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, ne vlerësojmë që zgjerimi jo vetëm i profilin juridik, por edhe i shkencave të humane, do të bëjë të mundur një përmirësim dhe një ndjeshmëri akoma më të madhe në vlerësimin e raportit prind-fëmijë, në raportet psikologjiko-sociale brenda Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Kjo ishte paraqitja e shkurtër.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Projektligji që po diskutojmë sot është një propozim i ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe synon të ndryshojë një nen të ligjit “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar”. Ky projektligj është përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të punimeve të komisionit dhe, për rrjedhojë, është konform Rregullores së Kuvendit për t’u shqyrtuar në komision dhe ne jemi komision përgjegjës. Në shqyrtimin e këtij projektligji do të bazohemi te nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Do të doja të theksoja se ky projektligj është paraqitur para ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, për rrjedhojë i është referuar nenit 68 të Rregullores e Kuvendit të pandryshuar. Me ndryshimet që kemi bërë në Rregulloren e Kuvendit në vijimësi, qoftë Ministria e Drejtësisë, por edhe të gjitha institucionet e tjera që propozojnë projektligje dhe që vijnë nëpërmjet Këshillit të Ministrave, sugjeroj të mbajnë në konsideratë riformulimet dhe kërkesat, që kërkon neni 68 i Rregullores së Kuvendit, ku, në mënyrë të veçantë evidentohen një sërë kriteresh që duhet t’i përmbushë detyrimisht legjislacioni, por veçanërisht ajo pikë për të cilën flitet, që ka të bëjë me konsultimin publik të një projektligji dhe me përmbushjen e detyrimeve, që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma ndërkombëtare, apo në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, për të cilat Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një rezolutë edhe është i detyruar ta ndjekë zbatimin e saj.

Ky projektligj kërkon miratim me shumicë të thjeshtë, megjithatë, nëse do të më lejoni, unë do të doja të theksoja që ky projektligj është ndryshuar një herë në vitin 2015. Në atë vit “Komiteti i nenit 5” i përbërë nga organizata vendase dhe ndërkombëtare të fokusuara në fushën e të drejtave të fëmijëve, por edhe përfaqësues të ambasadave në Shqipëri, kanë kërkuar të bëjnë një sërë amendamentesh në projektligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit”, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve. Në këtë kuadër, kanë ndryshuar një sërë dispozitash të këtij projektligji, ndërkohë Ministrisë së Drejtësisë i është lënë detyrë të shohë ndryshimet në Kodin e Familjes, pasi ne ende jemi duke rregulluar marrëdhëniet e fëmijëve, pra rregullat e birësimit me legjislacionin, që koha e ka lënë pas, ndërkohë që ne kemi miratuar Konventën Ndërkombëtare të Hagës për të Drejtat e Fëmijëve e një sërë konventash të tjera.

Në këtë kontekst, unë kam një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, konkretisht për zëvendësministren Caka. A e ka Ministria e Drejtësisë parasysh këtë kërkesë dhe këtë detyrë të lënë nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2015, kur ne diskutuam ndryshimet në projektligjin, që ju sillni përsëri për ta ndryshuar?

Kam lexuar me vëmendje relacionin dhe ju sillni vetëm ndryshimin e një neni për kriteret e përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit, i cili është njëkohësisht pjesë e komitetit që vlerëson kriteret e birësimit. Pra, ju kërkon të riktheheni në rregullimin e mëparshëm që ka pasur ligji “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit”. Unë ndoqa dy argumente që ju keni sjellë. Keni menduar që ky kufizim është joproporcional, pra kërkohet të ketë një mundësi për të pasur kandidatë edhe nga fusha të tjera, si në psikologji, apo shkencat sociale. E dyta, ju përmendët në fjalën tuaj, që në këtë periudhë, besoj se keni rreth dy vjet që keni vakancën, nuk keni pasur kandidatë të përshtatshëm.

Unë kam një pyetje lidhur me përbërjen e Komitetit: Komiteti që merret me procedurat e birësimit dhe vlerësimit ka përfaqësues edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucione të tjera dhe në faqen 2 të relacionit ju thoni që shumica e stafit dhe e përfaqësuesve janë juristë, pra keni mjaftueshëm juristë dhe konstatoni një mungesë të profesionistëve që u përkasin fushave të tjera, siç janë shkencat sociale. A mund të më thoni, ju lutem, se cila është përbërja aktuale e Komitetit? Nuk e dua me emra, por me profesione dhe me *background*. Cili është *background*-i i përfaqësuesve që sjellin ministrinë në përbërje të këtij Komiteti?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zonja Caka.

Fjoralba Caka – Faleminderit, zonja Hysi për pyetjet tuaja!

Lidhur me Konventën e Hagës për Birësimin unë, me lejen e komisionit, do të ndaloja shkurtimisht në disa dispozita, ku ne bazohemi dhe forcojmë bindjen që rangi i kandidatëve duhet të jetë përtej atyre që janë thjesht juristë. Po të shohim nenin 11, pika “b” të Konventës së Hagës për Birësimin, për sa i përket drejtuesit të institucionit, kërkohet që institucioni, pra autoriteti i akredituar, të drejtohet nga një personel me persona të kualifikuar në normën e sjelljes, që kanë kualifikim dhe përvojë në punën në fushën e birësimit. Pra, kriteri që parashikon neni 11, pika “b” e Konventës së Hagës, i jep një element të shtuar kualifikimit dhe përvojës në fushën e birësimit dhe nuk ndalet thjesht tek ajo që konsiderohet formimi shkollor akademik. E theksoj edhe një herë që i jep përparësi përvojës në fushën e birësimit.

Po të kalojmë te neni 15 ne kuptojmë në mënyrë logjike pse kërkohet të ketë përvojë në fushën e birësimit dhe kjo lidhet me faktin se neni 15, paragrafi i parë i Konventës të Hagës kërkon nga autoritetet qendrore të shtetit të përgatisin një raport, i cili të përfshijë informacion për identitetin e fëmijës, të drejtën dhe pritshmërinë për t’u birësuar, biografinë e tyre, familjen, gjendjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim e kështu me radhë.

Pa e lodhur komisionin, dispozita e fundit është neni 22, ku thuhet: “Funksionet e autoriteti qendror, mbi bazën e këtij kapitulli, mund të kryhen nga autoritetet publike ose

organe të akredituara” dhe kriteret që ata paraqesin më pas te neni 22, pika 2, janë a) të përmbushë kërkesat e integritetit, b) kompetenca profesionale, c) përvojë dhe përgjegjshmëri, d) të jenë të kualifikuar për normat morale, e) kualifikim dhe përvojë në fushën e birësimit.

Nga leximi i këtyre dispozitave, ne kuptojmë që theksi i Konventës së Hagës nuk është formimi profesional, qoftë ky në fushën e drejtësisë apo të shkencave sociale, por përvoja dhe ekspertiza në fushën e birësimit.

Pikërisht për këtë ne synojmë të bëjmë amendamentin, pra të mos kërkojmë thjesht persona që kanë një diplomë në drejtësi, por të tërheqim ata kandidatë, të cilët, për shkak të profesionit të tyre si psikologë, kanë përvojë në fushën e birësimit. Kjo ka qenë kërkesa për ta sjellë këtë në përputhje me frymën e dispozitave të konventës, që sapo lexova.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë ju kam thënë që në fillim të herës që Komisioni i Ligjeve nuk bën ligje, por ngre gracka për institucionet. Unë e mbështes zonjën Hysi, që kërkoi përbërjen e këtij komiteti për të parë se si funksionon.

E dyta, mua më duket sikur privohen të drejtat që kërkohen në ndryshimin e projektligjit, duke përcaktuar që ky duhet të ketë arsimin vetëm në drejtësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ju po e hiqni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, se juve, kur nuk ju pëlqen, hidheni të gjithë.

Pra, e gjithë ideja ime është që, në një ligj të tërë kërkoni të ndryshoni vetëm një nen. Qëllimi im, si anëtar i këtij komisioni, është të them se ju doni të ndryshoni këtë ligj për një nen, për të zgjedhur njeriun përkatës, që, në rastin konkret, e keni bërë gati. Pyetja është: kush është personi, që doni të zgjidhni?

Ulsi Manja – A ka përgjigje për pyetjen e kolegut Alimadhi?

Fjoralba Caka – Faleminderit për pyetjen, zoti Alimadhi. Lidhur me ndryshimin, ndoshta nuk isha e qartë dhe më lejoni ta theksoj edhe një herë. Në ligjin aktual kriteri i vendosur është që personi duhet të ketë diplomë në Drejtësi, pra duhet të jetë i diplomuar për Drejtësi.

Ndërkohë, ne synojmë të mos e kufizojmë në Drejtësi, por ta zgjerojmë gamën, duke përfshirë Shkencat Juridike, Shkencat Sociale dhe Shkencat Humane. Pra, të mos jetë thjesht psikolog apo punonjës social, por edhe me shkenca humane, siç mund të jetë një gazetar i zoti,

që është marrë me fushën e birësimit dhe ka një përvojë të kualifikuar. Pra, pse të mos i japim mundësinë që kryetari i këtij komiteti të jetë një personazh ose një person i identifikuar dhe i specializuar në këtë fushë, për ta marrë këtë post. Ne kërkojmë ta zgjerojmë për të mos e lënë ngushtësisht me përvojë vetëm në fushën juridike.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Fjalën e ka kërkuar zoti Fino.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mbaruat?

Më falni, zoti Fino!

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – U tërhoqa nga pyetja e parë që bëra. Jam dakord për këtë pjesë.

Tjetra, nga ana ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hyn në fuqi menjëherë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord? Meqenëse i keni votat, vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është ideja. Ju keni sjellë një ndryshim në këtë ligj vetëm për një paragraf. Pra, ju duhet vetëm personi.

Nëse hyn në fuqi menjëherë, dakord.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, ju lutem!

Zoti Fino ka kërkuar fjalën për pyetje, sepse në tekstin e projektligjit janë dy nene, 1 dhe 2, që do t'i votojmë më vonë.

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Mund të ketë dy nene dhe shumë pyetje, por pak rëndësi ka kjo.

Për shkak të memories së këtij komisioni, duhet ta ndihmoj edhe zotin Alimadhi, cili nuk ka qenë këtu, pasi unë kam qenë, siç e tha edhe relatorja, në vitin 2015 unë kam bërë një vërejtje: Pse e kufizojnë kryetarin e Komunitetit Shqiptar të Birësimeve vetëm me profesion jurist? Në atë kohë u tha se duhet patjetër jurist, sepse duhet të njohë ligjet e vendit, ligjet e huaja dhe të tjera, pasi ëshë e domosdoshme...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të më lejoni të flas, apo të tërhiqem?

Ulsi Manja – Zoti Shameti!

Bashkim Fino – Nuk ndërhyj te askush kur flet, ndaj nuk dua të më ndërhyjë njeri.

Këta të maxhorancës janë mësuar të jenë të pasjellshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoj?

Ulsi Manja – Dje ka qenë dita e parë e shkollës, zoti Fino, por nuk kishim mbledhje komisioni.

Bashkim Fino – Mund të vazhdoj të flas?

Unë e kam fajin, apo e keni ju?

Ulsi Manja – Po, mund të vazhdoni!

Bashkim Fino – Para 4 vjetësh na u tha se duhet një jurist i mirë, që të njohë ligjet vendase dhe të huaja, atë që relatorja e ka shkruar sot në relacion me pak fjalë. Sot pas 4 vjetësh na thuhet: sikur ta shtrijmë pak profesionin, të mos jenë vetëm juristë, të sociologë, psikologë, gazetarë të shquar e të tjera, ndërkohë që këtë mendim ne e kishim para 4 vjetësh, kur kemi thënë: ta kemi vërtet kështu kryetarin e Birësimeve. Pra, të jetë gjithëpërfshirës, jo vetëm i një fushe të caktuar. Sot vijnë në konkluzionet që, pak a shumë, kemi thënë ne si komision para 4 vjetësh.

Pyetja ime është e thjeshtë: në këta 4 vjet, kryetari i Komitetit të Birësimeve, që ishte një jurist i zoti, sipas përzgjedhjes suaj dhe sipas ligjit, në jurisprudencën vendase dhe të huaj, i ka zgjidhur, i ka rezauruar problemet juridike në këta 4 vjet? Nuk kemi më probleme juridike? Mund të vendosim tani një kryetar me profesion gazetar, psikolog apo me shkenca sociale e të tjera? Unë, jam plotësisht dakord me projektligjin, siç kam qenë edhe para 4 vjetësh, sepse do të ketë një diapazon më të gjerë, por meqë kemi pasur një kryetar të tillë, nuk kanë ecur siç duhet punët? Kjo është ajo që ne diskutojmë dhe e kemi diskutuar edhe para 4 vjetësh.

Unë sot jam shumë i lumtur dhe i kënaqur që projektligji ka ardhur me këtë zgjidhje, të cilën e kam pasur edhe para 4 vjetësh.

Faleminderit, kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Caka ka përgjigje për pyetjen e kolegut Fino.

Ju lutem, vazhdoni!

Fjoralba Caka – Nuk do ta zgjas shumë, por thjesht dua të them se që nga viti 2017, për të shpjeguar situatën dhe nevojën, ne i kemi kryetarët të komanduar. Pra, për shkak të kësaj vakance dhe aplikimeve të paraqitura deri tani, kemi dalë në konkluzionin se na duhen persona me eksperiencë dhe ekspertizë në fushën e birësimit.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Kam një pyetje praktike për përfaqësuesen e ministrisë.

I gjithë procesi i punës i këtij institucioni ka ecur vaj, që ju jeni investuar si një ministri e të tërë për të ndryshuar vetëm një nen të ligjit? Unë si deputet i zonës jam interesuar disa herë, sepse ka aplikantë që presin vite për birësim dhe nuk e kanë realizuar dot. Diçka çalon te puna. Nuk besoj se është çështja e një kriteri. Nga pikëpamja profesionale, mendoj se këto kriteret nuk duhet të jenë në ligj, por në VKM.

Nga ana tjetër, kushdo që është jurist, e kupton që birësimi nuk është proces psikologjik, gazetaresk apo human për ata që kanë shëtitur botën, por institut juridik. Ju si juriste dhe ministrja besoj se e dini që një institut juridik kërkon jurist, por është tjetër gjë nëse duhet të jetë në ligj. Nëse do ta votoja, do ta votoja të mos ishte në ligj, por me VKM, por që të votoj të heqim juristin dhe të vendosim një psikolog, sepse psikologu pyetet nga gjykata, është nonsens. Edhe mjeku pyetet në këto raste. Kur bëhet dosja, pyetet edhe mjeku. Ta vendosim mjek? Të mos bëjmë gafa që nuk na falen profesionalisht. Të mos investohemi në gjëra që nuk janë thelbësore.

Unë jam gati që nga mëngjesi deri në darkë të punojmë për të bërë një ligj më praktik, që ta ndihmojmë këtë proces, këtë kategori fëmijësh, që mund t'u gjejmë familje, si dhe kategorinë e prindërve që kërkojnë fëmijë. Nuk më duket serioze të merremi me këto gjëra dhe unë në parim deklaroj votën kundër.

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

I ndoqa diskutimet e kolegëve. Në fakt, unë kam sjellë në relacion edhe një pjesë të argumenteve që kanë bërë përfaqësuesit e Komunitetit Shqiptar të Birësimeve nga debati i projektligjit në vitin 2015. Për rrjedhojë, nuk e lexova, pasi të gjithë ju keni relacionin përpara.

Megjithatë, unë ritheksoj nevojën për të pasur një reformë të thellë për çështjet e proceseve të birësimeve dhe për të drejtat e fëmijëve, përfshirë edhe kujdestarinë, të parashikuar në Kodin e Familjes. E theksojmë këtë, pasi e mbaj mend shumë mirë debatin dhe diskutimet që kemi bërë në vitin 2015, sikurse e tha edhe kolegu Fino, kur kemi theksuar dhe jemi bazuar në konsultimin e gjerë publik për ndryshimet e sjella në atë kohë, që nuk ka aq shumë rëndësi kufizimi i periudhës së birësimit, sesa rregullimi i kriterëve të tjera, që përcaktohen në Kodin e Familjes.

Do të doja që Ministria e Drejtësisë të investohet dhe do ta vlerësoja nëse do të kishim informacion për ngritjen e ndonjë grupi pune, për të bërë ndryshime në Kodin e Familjes për

kujdestarinë, për procedurat e birësimit, bazuar në rekomandimet që kanë bërë Save the Children, Terdo Zone, UNICEF-i, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, për të qenë në përputhje me konventat e ratifikuara nga Kuvendi në vitin 2013 e në vazhdim.

E kam theksuar në vitin 2015 dhe e ritheksoj: është shumë e rëndësishme nëse ne duam të ecë procesi i birësimeve, që t'i sigurojmë fëmijës një familje birësuese brenda territorit të Shqipërisë, ose, nëse ka mundësi, ta mbajë familja biologjike, por mendoj se duhen rregulluar shumë gjëra në Kodin e Familjes, për të pasur një trajtim sa më të mirë të interesit më të lartë të fëmijëve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Para se ta kalojmë projektligjin për votim, edhe unë kam dy fjalë për të thënë, sepse kam qenë pjesë e diskutimit kur është ndryshuar ky ligj në vitin 2015.

Ligjet nuk janë statike, janë dinamike, dhe, natyrisht, duhet t'u përgjigjen sfidave të kohës. Sot, pas 4 vjetësh, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave, vijnë me propozimin që në nenin 10 duhet të zgjerohet gama e arsimit që duhet të ketë kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve ose anëtarët e këtij komiteti. Unë jam dakord me zotin Hyseni, që birësimi është institut shumë i rëndësishëm juridik. Çështjet e birësimit janë sa probleme juridike, aq edhe humane dhe sociale. Unë, absolutisht, ndaj të njëjtin mendim, që ky ndryshim ligjor, i diktuar nga praktika e 4 vjetëve, që e kufizuar vetëm në arsimin juridik, siç duket, nuk ka pasur kapacitetet e duhura për ta trajtuar këtë institut juridik. Nuk ka asgjë të keqe që pika 2 e nenit 10 të mos kufizohet vetëm në arsimin e shkencave juridike, por të zgjerohet në shkencat humane dhe sociale.

Unë jam i mendimit se integriteti i njerëzve që shkojnë aty është shumë i rëndësishëm, sepse, edhe nëse je jurist strikt, nuk do të thotë që di ta bësh mirë punën si kryetar ose si anëtar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve. Mund të jetë një profesionist që nuk ka lidhje me shkencat humane, shkencat juridike apo sociale, por ka integritet të lartë profesional dhe moral për fushën nga vjen, si dhe njohuritë e duhura në fushën e birësimeve. Pra, ky është një ndryshim ligjor, që e propozon Ministria e Drejtësisë, por ajo që ia vlen të diskutohet sot është se kur vijnë këto propozime, si ndryshimi që u bë në vitin 2015, është mirë të bëhet një studim se pse duhet kufizuar, të ketë një arsyetim cilat janë shkaqet pse duhet bërë ky ndryshim ligjor dhe të mos bëhen të shpejtuara, sepse, në këndvështrimin që ju kërkoni sot është kthim në variantin e ligjit para vitit 2015. Pra, kjo tregon se ai ndryshim nuk ia vlejti. Unë jam plotësisht dakord ta kalojmë këtë projektligj.

Ndryshimi ligjor ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Këshilli i Ministrave. Për rrjedhojë, në krye të Komitetit Shqiptar të Birësimeve është ende një person i komanduar. Nëse

do të jemi me struktura të përkohshme, nuk mund të ecin birësimet dhe të zbatohet ky institut i rëndësishëm juridik. Gjendja e përkohshmërisë nuk i shërben zbatimit të ligjit.

Mendoj ta kalojmë në votim në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9695, datë 13.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi ky projektligj.

Relatorja të bëjë gati raportin e komisionit dhe më pas ta kalojmë në seancë plenare.

Para se të mbyllim mbledhjen e komisionit, dua të sqaroj për kolegët, por edhe për opinionin publik që sot në rendin e ditës kishim edhe projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, por së bashku me këtë projektligj është në diskutim edhe një ligj i ri “Për shërbimet medietike” dhe të dyja këto projektligje, në formë pakete, janë në diskutim me ekspertizën më të lartë të OSBE-së në këtë fushë, si një garanci e shtuar për cilësinë e këtyre dy projektligjeve që janë në Kuvendin e Shqipërisë, me sugjerimin e relatores, por edhe të kolegëve, që janë të përfshirë në diskutimin e këtij projektligji dhe në grupin e punës që punon me OSBE-në, prandaj po punohet për t’i sjellë të dyja këto projektligje në variantin më të mirë të mundshëm. Ky projektligj u hoq sot nga rendi i ditës për t’u rifutur në tryezën e diskutimeve së bashku me ligjin “Për shërbimet medietike”, kur të kemi edhe produktin e tryezës së konsultimit që ka filluar me OSBE-në.

Faleminderit, kolegë, për prezencën në mbledhjen e sotme!

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës, do t’ju njoftohen nga sekretaria e komisionit nëpërmjet postës elektronike.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA